



► **MINISTRI I AKORDIMIT TITULLIN "AMBASADORI I KOMBIT"** AKTIVITETI DHE INTEKTUALI ASTRI LKA, NISMETARIT DHE REALIZUESIT TE VENDOSJES SE BUSTIT TE HEROIT TONE KOMBETAR GJERGJ KASTRIOTI SHKENDERBEU NE GJENEVE, ZVICER.



► **DR. ARMAND AGOLLI U VLERESUA NGA MINISTRI I SHTETIT PER DIASPOREN ME TITULLIN "AMBASADORI I KOMBIT"**. NEUROKIRURGU PER ME SHUME SE 10 VITE KA QENE PUES E EKOPEVE MIJEKESORE NE SUEDI. AKTUALISHT BASHKEPUNON ME SPITALET NE SHQIPERI DHE KOSOVE.



► **KONSULLI I NDERIT I IZRAELIT, NE SHQIPERI RODOLF XHILLARI MERR VLERESIMIN "AMBASADORI I KOMBIT"**, NGA MINISTRI I SHTETIT PER DIASPOREN.

# NEWSLETTER E DIASPORËS



AGJENCIA  
KOMBËTARE E  
DIASPORËS



FONDI SHQIPTAR  
PER ZHVILLIMIN E  
DIASPORËS



QENDRA E  
BOTIMEVE PER  
DIASPOREN

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

## Ministri në Senatin italian, merr pjesë në konferencën "Minoranca Arbëreshe, feja, kultura, tradita"

Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko mori pjesë në konferencën "Minoranca Arbëreshe, feja, kultura, tradita" që u zhvillua në Senatin italian në Romë. Në fjalën e tij ministri u ndal te historia e komunitetit arbëresh, pjesë e pandarë e kombit dhe mbi të gjitha pjesë thelbësore e historisë tonë.

Konferenca u organizua në kuadër të "100 vjetorit të institutit të Eparkisë së Lungros". Ky jubile i Eparkisë së Ungros është event i më të rëndësishëm fetar për komunitetin arbëreshë.

Eparkia e Ungros është krijuar më 13 shkurt të vitit 1919 nga Papa Benedikti i XV, dhe ruan e mbron gjuhën, zakonet e pasurinë fetare e kulturore të minoritetit arbëreshë në Itali. Bazuar në ritin greko-bizantin ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë shekullore të arbëreshëve të Italisë në kultivimin e gjuhës e ruajtjen e identitetit të tyre. Të gjitha ceremonitë e festat fetare kryhen në gjuhën shqipe e greke e rrallë herë në gjuhën italiane.



## Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës publikon "Periodikun" e tij të parë

Për herë të parë Fondi i Zhvillimit për Diasporën publikon një material të plotë me raporte, analiza, studime me fokus Diasporën. Këto studime janë realizuar nga institucione të ndryshme si Banka e Shqipërisë, Instituti i Statistikave, Banka Botërore, etj dhe përfshijnë punime shkencore nga akademikë dhe kërkues shkencorë.

Qëllimi i këtij publikimi është paraqitja e një analize të plotë të situatës sociale dhe ekonomike të Diasporës si dhe parashtrimi i alternativave për ta integruar Diasporën në shoqërinë shqiptare. Ky periodik, i cili do të botohet një herë në gjashtë muaj, është një ftesë për ta ngritur diskutimin e studiuësve për migracionin shqiptar në nivel të një cilësie gjithëpërfshirëse dhe reflektuese. Ai do të përmbledhë po ashtu dokumentet më të rëndësishme të raporteve shtetërore dhe të shoqërisë civile për Diasporën shqiptare: <https://online.flippingbook.com/view/449496>

## Agjencia Kombëtare e Diasporës me faqe të re elektronike



Agjencia Kombëtare e Diasporës tashmë ka një faqe të re elektronike. Në adresën <http://akd.gov.al/> mund të informoheni për të gjitha aktivitetet e agjencisë, projektet dhe ecurinë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 si dhe të rejtat më të fundit. Agjencia Kombëtare e Diasporës është organi shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me Diasporën. Zbaton politikën dhe projektet që lidhen me Diasporën, përgatit dhe koordinon punën për hartimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën, si dhe mban lidhjet ndërmjet Diasporës, përfaqësuesve të saj dhe vendit të origjinës. Gjithashtu bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës në botë si dhe ndihmon në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, vlerave kombëtare dhe kulturore të Diasporës: [www.akd.gov.al](http://www.akd.gov.al)

## Gjatë takimit me grupin e koordinatorëve për zbatimin e planit të veprimit të "Strategjisë Kombëtare Për Diasporën 2018-2024", ku u diskutua për konkluzionet e Samitit të Dytë të Diasporës

